



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 08.05.2025
Numër Protokolli: 3268/2025

A.nr.391/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.391/2025, të datës 28.02.2025, të parashtruar nga grupi i ankuesve E.V., S.S., R.M., V.M. dhe F.K., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Avokat Ardian Pllana, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa, A.nr.391/2025, e datës 28.02.2025, e parashtruar nga ankuesit E.V., S.S., R.M., V.M. dhe F.K.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, E.V., S.S., R.M., V.M. dhe F.K., (*tutje referuar vetëm: Ankuesit*), të cilët me autorizimi i përfaqëson Avokat Ardian Pllana më datë 28.02.2025 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.391/2025 në emër të ankueses E.V. (grup ankuesish), kundër Përgjigjes me numër protokolli 249 të datës 27.02.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesve tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 24.03.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 2463/2025 të datës 14.04.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1348/2025; Përgjigjen me numër protokolli 249 të datës 27.02.2025; Kërkesën me numër protokolli 233 të datës 21.02.2025; Autorizimet dhe dokumentet e identifikimit të ankuesve; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 24.03.2025; Kërkesën me numër protokolli 278 të datës 03.03.2023; Vendimin me numër protokolli 01/1002 të datës 25.06.2009; Shkresën e datës 26.08.2009; Kontratat e punës të ankuesve dhe listat e tyre të pagave.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesve është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesit janë të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Si rrjedhojë, të njëjtit përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, me datë 21.02.2025 kanë parashtruar kërkesë tek organi i punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës për njohjen e shtesës së rrezikshmërisë në punë në vlerë prej 107 €uro, duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ/MD-nr.08/2013 me arsyetimin se sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO/79 të datës 23.01.2024, është shfuqizuar paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Tutje, ankuesit në kërkesën e tyre kërkojnë kompensimin në mënyrë retroaktive të shumës 107 €uro në bazë mujore, për periudhën kohore nga juaji shkurt 2023 kur ka hyrë ligji i pagave në fuqi si dhe duke e njohur vazhdimësinë e kësaj shtese në të ardhmen.

Lidhur me kërkesën e tyre të datës 21.02.2025, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datë 27.02.2025 ankuesve i'u ka kthyer përgjigje me arsyetimin se shtesën me vlerë prej 107€uro për rrezikshmëri palët e kanë realizuar në bazë të Vendimit të Ministrisë së Drejtësisë nr.01/1002 të datës 25.06.2009, mirëpo akti në fjalë është shfuqizuar përmes Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin publik. Tutje Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së, përmes përgjigjes së datës 31.01.2025 i njofton palët se organi i punësimit me datat 03.03.2023 dhe 31.07.2024 ka përcjellë kërkesën shtesa të përcaktuara sipas Rregullores së re, tek Komisioni Shtetëror për Kushte Specifike të Punës.

Ankuesit, në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër Përgjigjes së datës 27.02.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së, pretendojnë se të njëjtën shtesë të cilën e kanë realizuar me herët në vlerë prej 107€uro në baza mujore, pas hyrjes në fuqi nga muaji shkurt 2023 i Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik më nuk janë duke e realizuar, ndërsa e kundërshtojnë si të paligjshme përgjigjen e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së me arsyetimin se Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin e saj në rastin KO/79 të datës 23.01.2024, e ka shfuqizuar paragrafin 2 të nenit 45 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe si rrjedhojë pretendojnë se Udhëzimi Administrativ/MD-nr.08/2013 dhe Vendimi i Ministres së Drejtësisë Nr.01/1002 i datës 25.06.2009 janë në fuqi, me kërkesën që Këshilli të aprovoi si të bazuar ankesën e tyre, ndërsa të obligoj SHKK-në, tua kompensoi në mënyrë retroaktive shumën në vlerë prej 2,461.00 për periudhën kohore nga muaji shkurt të vitit 2023 e deri në muajin dhjetor 2024 në emër të shtesës së rrezikshmërisë prej 107€uro në muaj.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe me rastin e vendimmarrjes mori për bazë dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, në fuqi nga data 05.02.2023, me theks të veçantë: Nenin 1 [Qëllimi] ku përcaktohet se: *1. Qëllimi i këtij ligji është që të krijohet një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijohet një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë*, Nenin 2 [Fushëveprimi] paragrafi 1 dhe 3 ku përcaktohet se: *1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen*

nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”, Nenin 41, paragrafi 2, 3 dhe 4, përcaktohet: 2. Të punësuarat/it, zyrtarja/i publik/e apo funksionarja/i publik/e, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, do të përfitojë pagën e re në: 2.1. 100% të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. 50 % të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 3. Përjashtimisht nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm nuk gëzojnë të drejtën e shtesës tranzitore. 4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore, Nenin 45 paragrafi 2, përcakton: 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t’u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji. Kolegji i Këshillit, thekson faktin e pakontestueshëm se Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, është shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe më datë 23.01.2024, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka publikuar Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, i cili ka hyre në fuqi më datë 01.02.2024. Përmes këtij aktgjykimi, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ka shpallë të pavlefshëm paragrafit 2, 3 dhe 4 të nenit 41 dhe paragrafin 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ndërsa ka detyruar Kuvendin e Republikës së Kosovës që brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi të ndryshojë dhe plotësojë paragrafin 2 të nenit 2 dhe paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë.

Kolegji i Këshillit, në ndërlidhje me shqyrtimin e çështjes së ngritur nga pala, konstaton faktin se është fakt i pakontestueshëm që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përmes aktgjykimit të cekur si më lartë ka shpallur të pavlefshëm paragrafin 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, mirëpo përmes këtij Aktgjykimi, në **IV. Efektet e Aktgjykimit** ka sqaruar dhe përcaktuar çështjen e efekteve juridike të këtij aktgjykimi në raport ligjin e kontestuar, ashtu që me pikën 377 të këtij aktgjykimi, specifikon se: Gjykata ka konstatuar se paragrafi 2 i nenit 2 (Fushëveprimi) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi), në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafi 5 i nenit 25 (Shtesa e performancës) dhe paragrafi 4 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën për sa i përket pavarësisë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese, me theks në institucionet e përcaktuara përmes Kapitullit VII [Sistemi i Drejtësisë], Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura]. Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, (i) paragrafi 2 i nenit 2 të Ligjit të kontestuar ua pamundëson institucioneve të pavarura kushtetuese që në përmbushje të pavarësisë së tyre kushtetuese të funksionojnë edhe me ligje të veçanta dhe e kufizon pavarësinë e tyre funksionale, organizative dhe buxhetore vetëm në nxjerrjen e akteve nënligjore në rrethanat e përcaktuara specifikisht sipas Ligjit të kontestuar; (ii) paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit të kontestuar shfuqizon çdo dispozitë të ligjit dhe akt nënligjor që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorive tjera në fushën e pagave, përfshirë të gjitha dispozitat e ligjeve të veçanta që ndërlidhen me institucionet e pavarura kushtetuese dhe aktet e tyre nënligjore; dhe (iii) paragrafët 2 dhe 3 të nenit 42 të Ligjit të kontestuar të lexuar së bashku me paragrafin 2 të nenit 2 të tij, i detyrojnë institucionet e pavarura kushtetuese që t’i nënshtrohen kontrollit të pushtetit ekzekutiv lidhur me përcaktimin e ekuivalencave, përkatësisht krijimin e funksioneve pozitive dhe emërtesave në institucionet e tyre në kundërshtim me garancitë përkatëse kushtetuese dhe praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës”, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, vlerëson se nëse analizohet mirë kjo pikë (377) në kuptim sqarimit të

efekteve juridike të aktgjykimit, përmes të njëjtit sqarim arrihet në përfundimin se me pikën VII të dispozitivit të Aktgjykimit, Gjykata Kushtetuese paragrafin 2 të nenit 45 të ligjit të cekur si më lartë, e ka shpallur të pavlefshëm vetëm për Institucionet e Pavarura Kushtetuese.

Me vetë faktin që sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është detyruar Kuvendi i Republikës së Kosovës që brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi të ndryshojë dhe plotësoj paragrafin 2 të nenit 2 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, sipas këtij aktgjykimi, është konstatuar fakti se me rastin e plotësimit ndryshimit të këtij paragrafi të qartësohet shprehimisht që institucionet e pavarura kushtetuese rregullojnë dhe zbatojnë procedurat përkatëse të Ligjit të kontestuar, jo vetëm përmes akteve nënligjore, por edhe ligjeve të veçanta në përputhje të plotë me pavarësinë e tyre funksionale, organizative dhe buxhetore të garantuar me Kushtetutë, rrjedhimisht sipas interpretimit apo efekteve të Aktgjykimit për rastin nr. KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pavlefshmëria e paragrafit 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Pagat në Sektorin Publikë nuk mund të ndërlidhet me institucionet e tjera shtetërore, sepse sipas Kolegjit të Këshillit, nëse i referohemi këtij aktgjykimi i njëjti ka lënë në fuqi të gjitha shtojcat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, të cilët janë të zbatueshme përveç për institucionet e pavarura kushtetuese ku është garantuar pavarësia kushtetuese e ku këto shtojca aplikohen por në raport me këtë aktgjykim.

Po ashtu, Gjykata Kushtetuese përmes sqarimeve të dhëna tek pjesa **IV. Efektet e Aktgjykimit**, ka sqaruar me pikën “376. Konstatimet e Gjykatës sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, ndikojnë në efektet e këtij Ligji në dy mënyra. **E para** ndërlidhet me konstatimet e Gjykatës lidhur me sistemin e pagave dhe shpërblimeve dhe procedurave përkatëse për atë sa afektojnë pavarësinë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese; **ndërsa e dyta** ndërlidhet me konstatimet e Gjykatës lidhur me zbritjen e nivelit të pagës së funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të Shtojcave të Ligjit të kontestuar, sipas sqarimeve në vijim:..”, ashtu që në sqarimet e dhëna përmes pjesës **IV. Efektet e Aktgjykimit**, duke filluar nga pika 373 e deri tek pika 388, Gjykata Kushtetuese sqaron çështjet e vendimmarrjes sipas dispozitivit të të njëjtit aktgjykim, ashtu që përmes të njëjtave pika arrihet në përfundimin se paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, është shpallur i pavlefshëm vetëm ndaj Institucioneve të pavarura kushtetuese dhe Sistemit të drejtësisë, ndërsa paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, shpallen të pavlefshëm për zbatim për të gjitha institucionet shtetërore, e në rrethanat e rastit konkret edhe për Shërbimin Korrektues të Kosovës, pasi në këtë kontekst Gjykata Kushtetuese përmes pikës 385 sqaron se: “385. Bazuar në pretendimet dhe argumentet e parashtruara para saj, Gjykata nuk ka trajtuar Shtojcat që janë pjesë përbërëse e nenit 44 të Ligjit të kontestuar. Përkundër faktit që (i) bazuar në vet Ligjin të kontestuar, ulja e pagës mund të bëhet vetëm si rezultat i një tronditje makroekonomike e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave dhe/ose një fatkeqësie natyrore sipas kuptimit të nenit 131 të Kushtetutës, përkatësisht shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës; dhe (ii) emëruesit të përbashkët të praktikës gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese, GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, që ulja e pagës, në parim, mund të bëhet vetëm në rrethana të krizave ekonomike dhe/ose financiare, Gjykata ka vlerësuar qëllimin e Ligjit të kontestuar për të krijuar “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” si qëllim legjitim. Për pasojë, ajo nuk ka shpallur në kundërshtim me Kushtetutën nenin 44 të Ligjit të kontestuar përkitazi me Shtojcat në lidhje me paragrafin 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar që përfshinë shfuqizimin e një numri të dispozitave të ligjeve të veçanta dhe të cilat rregullojnë pagën e një numri institucioneve në Republikën e Kosovës. **Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” arrihet përmes paragrafit 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar dhe sipas të cilit, nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të**

këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.

Tutje, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me rastin e trajtimit të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, çështjen e pagës e ka lidhur me të drejtën e pronës e cila nuk mund të tjetërsohet, dhe mbi këtë konstatim ka folur edhe për çështjen e shtesës tranzitore, e ku Kolegji i Këshillit ju referua pikës 383 të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, ku thuhet: *Ndërsa, në balancimin në mes të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, Gjykata, përmes këtij Aktgjykimi do të shpallë të pavlefshme dhe do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. Shfuqizimi i paragrafëve që ndërlidhen me periudhën tranzitore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e (i) mbajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik, përkatësisht pamundësinë e zbritjes së pagave deri sa paga e re të 110 bëhet e barasvlershme me pagën aktuale; (ii) kthimin e pagës të paktën në nivelin para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar për kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk kanë përfitur nga shtesa tranzitore prej njëqind përqind (100%) përgjatë vitit 2023, për dallim nga të gjitha kategoritë tjera; dhe (iii) nivelizimin e pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të pikës 1.4 të nenit 4 (Parimet e sistemit të pagave) të Ligjit të kontestuar”, rrjedhimisht sipas këtij përcaktimi, shtesat tranzitore do të jenë aktive derisa paga e re të bëhet e barasvlershme me pagën aktuale, në rrethanat kur sipas ligjit të ri të pagave një nëpunësi i ka rezultuar që paga të jetë me vogël sesa që paga që ka realizuar para hyrjes në fuqi të ligjit të ri për paga.*

Mirëpo ne rrethanat e rastit konkret, asnjëri nga ankuesit e përcaktuar si në këtë vendim, me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk janë dëmtuar në pagë, gjegjësisht Kolegji i Këshillit sipas dëshmive të ofruara nga Njësia e Burimeve Njerzore e SHKK-së, ka konstatuar se ankuesja **E.V.** sipas listës së pagave të muajit janar të vitit 2023, për të njëjtin muaj ka realizuar pagë e përgjithshme neto në vlerë prej **434.47€** (e që në këtë vlerë ka qenë e përfshirë edhe shtesa e rrezikshmërisë në vlerë prej 107€uro), ndërsa e njëjta sipas listës së pagave në muajin shkurt të vitit 2023 ka realizuar pagë e përgjithshme neto në vlerë prej **525.84€**; ankuesi **F.K** sipas listës së pagave të muajit janar të vitit 2023, për të njëjtin muaj ka realizuar pagë e përgjithshme neto në vlerë prej **434.47€** (e që në këtë vlerë ka qenë e përfshirë edhe shtesa e rrezikshmërisë në vlerë prej 107€uro), ndërsa i njëjti sipas listës së pagave në muajin shkurt të vitit 2023 ka realizuar pagën e përgjithshme neto në vlerë prej **525.84€**; ankuesja **S.S** sipas listës së pagave për muajin shkurt 2024, për të njëjtin muaj ka realizuar pagën e përgjithshme neto në vlerë prej **315.60€** në cilësi të kadetes korrektues, ndërsa sipas listës së pagave për muajin gusht 2024, e njëjta për këtë muaj ka realizuar pagën e përgjithshme neto në vlerë prej **712.25€** (e që në këtë vlerë ka qenë e përfshirë edhe kompensimi për punën jashtë orarit të punës në vlerën prej 194.71€uro); ankuesi **AZ**, sipas listës së pagave për muajin shkurt 2024, për të njëjtin muaj ka realizuar pagën e përgjithshme neto në vlerën prej **315.60€**, në cilësi të kadetit korrektuese, ndërsa sipas listës së pagave për muajin gusht 2024, i njëjti ka realizuar pagën e përgjithshme neto në vlerën prej **728.91€**; si dhe ankuesi **R.M.**, sipas listës së pagave për muajin shkurt 2024, për të njëjtin muaj ka realizuar pagën e përgjithshme neto në vlerën prej **315.60€**, në cilësi të kadetit korrektuese, ndërsa sipas listës së pagave për muajin gusht 2024, i njëjti ka realizuar pagën e përgjithshme neto në vlerën prej **736.09€**;

Në kudër të kësaj, Kolegji i Këshillit, thekson faktin se ankuesit të përcaktuar si në dispozitivin e këtij vendimi nuk marrin pagë më të ulët me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, respektivisht të njëjtit pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri të pagave nga muaji shkurt i vitit 2023 realizojnë paga më të larta dhe të njëjtit paguhen sipas përcaktimeve ligjore në tabelën e koeficienteve të përcaktuar për Shërbimin Korrektues të Kosovës, respektivisht për të njëjtit aplikohet Shtojca NR.7 e

Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ku lidhur me pozitat e punës “Zyrtar Korrektues” është përcaktuar në Klasa T4, dhe koeficienti 5.5, ndërsa nga provat e lëndës arrihet në konstatimin se që të gjithë ankuesit paguhën sipas këtij përcaktimi ligjor, ndërsa për faktin se pavlefshmëria e paragrafit 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë ka të bëjë vetëm me institucionet e pavarura kushtetuese, kjo vërteton faktin se Udhëzimi Administrativ/MD-Nr.08/2013 dhe Vendimi i Ministres së Drejtësisë Nr.01/1002 të datës 25.06.2009 nuk janë në fuqi dhe si rrjedhojë pretendim ankimor i ankueseve për realizimin e shtesës së rrezikshmërisë në vlerë prej 107 Euro në baza mujore, nuk është i bazuar ngase nuk ka mbështetje ligjore, respektivisht i njëjti pretendim nuk gjen mbështetje në ligjin material për pagat në sektorin publik, sikurse ndërlidhur me këtë konstatim dhe përveç tjerash lidhur me pretendimin dhe kërkesën e njëjtë për ankuesen S.S, ankuesin V.M dhe ankuesin R.M, Kolegji i Këshillit thekson faktin të njëjtit nuk mund të kërkojnë kompensim në mënyrë retroaktive për një periudhë kohore kur nuk kanë pasur të themeluar marrëdhënien e punës në SHKK, ngase të njëjtit marrëdhënien e punës me SHKK-në e kanë lidhur me datë 17.07.2024 sipas Akteve të Emërimit me shifër:239/2024; 246/2024;249/2024 , kurse në muajin shkurt të vitit 2024, të njëjtit kanë qenë kadet/e korrektues sipas listës së pagave, prandaj edhe në rrethanat e rastit konkret përveç tjerash të thëna si në këtë arsyetim tek rastet e tilla kërkesa nuk gjëne mbështetje ligjore.

Kolegji i Këshillit konstaton se është për tu vlerësuar fakti se organi punëdhënës në përgjigjen e datës 31.01.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së, por edhe përmes përgjigjes së dhënë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, e konfirmon faktin se bazuar në kuadrin ligjor në fuqi për çështjen e pagave, respektivisht Rregullores Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, me datë 03.03.2023 dhe datë 31.07.2024, organi i punësimit i është drejtuar Komisionit Shtetëror për Kushte Specifike të Punës, me kërkesën që të punësuarve të uniformuar në SHKK tu njihet shtesa në pagë duke iu referuar kushteve dhe rrethanave të veprimit, respektivisht rrezikshmërisë në punë, duke u bazuar në kuadrin e ri ligjor në fuqi që trajton çështjen e pagave dhe shtesave të njohura sipas Ligjit nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Duke marrë parasysh, që palët ankuese si në ankesën e tyre të datës 28.02.2025 e kontestojnë vetëm Përgjigjen e datës 27.02.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se lidhur me vendimmarrjen si në dispozitiv u sqarua si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa palëve ankuese, në kohën kur mund të paraqiten apo krijohen rrethana të reja juridike lidhur me kërkesën e 31.07.2024 të bërë nga organi i punësimit tek Komisioni Shtetëror për Kushte Specifike të Punës, të njëjtit sipas rrethanave juridike të krijuar në kuptim të shqyrtimit të kërkesës së datës 31.07.2024, munden të hapin procedurë ankimore, mirëpo vetëm nën kushtet dhe rrethanat e përcaktuara ligjore të kuadrit ligjor në fuqi, gjegjësisht dispozitave të LPPA-së.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.391/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve, Avokat Ardian Pllana;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore);si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.